

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11) и „Службен весник на Република Северна Македонија“ 96/19 и 110/19), како и врз основа на член 22 и член 25 од Законот за средно образование („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 и 64/18) министерот за образование и наука донесе скратена наставна програма по наставниот предмет **Албански јазик и литература за I (прва) година на четиригодишното средно стручно образование** за учебната 2020/21 година.

**PROGRAM I SHKURTUAR
MËSIMOR**



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
Viti I

Shkup 2020/2021

Arsimi i mesëm profesional

1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi bazohet në rezultatet e pritura të parapara me programin mësimor për lëndën mësimore **Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e parë të arsimit të mesëm prfofesional** që rregullisht realizohet në akordim me Planin mësimor. Me programin e shkurtuar përcaktohen tema dhe njësi mësimore të caktuara që duhet të realizohen për **159** ditë misimore me ç'rast merret parasysh fondi javor i parashikuar i orëve i përcaktuar në programin e rregullt, gjegjësisht për këtë lëndë mësimore në akordim me **3** orët në javë të parashikuara në programin e shkurtuar mësimor duhet të parashikohen **96** orë të ndara barazisht në modulin Gjuhë dhe modulin Letërsi.

Msimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet prej rezultateve të arritura, nocioneve të përcaktuara, metodat dhe aktivitetet të miratuara në programin e rregullt mësimor.

2. Pasqyrimi i temave dhe njësive mësimore

Nr.re -ndor	Moduli Gjuhë Njësitë mësimore	Numri i orëve të propozuara për realizim
1.	Komunikimi, llojet e komunikimit –Gjuha si sistem shenjash	2
2.	Gjuha shqipe në familjen e gjuhëve indoevropiane dhe prejardhja e saj nga ilirishtja	2
3.	Dëshmitë e para shkrimore të gjuhës shqipe, Veprat e para të botuara në gjuhën shqipe me autorë Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani, Jul Variboba	4
4.	Fonetikë – Klaisifikimi i tingujve	2
5.	Ndryshimet tingullore -drejtshkrimi	2
6.	Theksi – Veçoritë e përgjithshme dhe llojet e theksit	2
7.	Morfologji – Struktura morfologjike e gjuhës, fjala dhe pjesët e saja përbërse	4
8.	Parimet e drejtshkrimit	1
9.	Drejtshkrimi i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve	3

10	Përdorimi i shkronjës së madhe, përdorimi i shkronjës së parë të vogël, shkrimi njësh, ndaras dhe me vizë në mes,shkurtesat dhe shkurtimi i fjalëve.	2
11	Shenjat e pikësimit.	2
12	Sintaksë- kuptimi për fjalinë - Struktura gramatikore e fjalisë	2
13	Gjymtyrët e fjalisë	1
14	Komunikimi dhe shkrimet funksionale	2
15	Përsëritije	8
16	Hartim me shkrim	6
	Numri i tërësishëm i orëve të realizuara nga moduli Gjuhë	45

Nr.ren- dor	Moduli Letërsi Njësitë mësimore	Numri i orëve të propozuara për realizim
1	Llojet e artit – Letërsia si art	1
2	Mitologjia dhe Miti – Përpunimi i një miti sipas për zgjedhjes së mësimdhënësit	2
3	Ndarja/ Tipologjia e letërsisë;	1
4	Lirika/elementet e lirikës dhe shprehjet stilistike.	2
5	Epika/elementet e epikës (ngjarjet,tema,narracioni,narratori,përmbajtja,koha dhe hapësira etj.)	2
6	Llojet epike në varg dhe prozë dhe llojet epiko lirike	2
7	Dramatika/elementet dhe llojet e dramatikës.	2
8	Letërsia e lashtë – Epi për Gilgameshin-elementet epiko lirike të veprës, interpretimi i përmbajtjes etj..	2
9	Homeri –bio-bibliografia dhe intertretimi i “Iliadës”	2
10	Virgjili -bio-biliografia dhe interpretimi i poemës “Eneida”	1
11	Marin Barleti –bio-bibliografia-“Historia e Skënderbeut”	2
12	Humanizmi dhe renesansa – Dante Aligieri-“Komedia Hyjnore”	1
13	Xhovani Bokaço –interpretim i tri novelave të zgjedhura nga “Dekameroni	1
13	Uliam Shekspir –interpretimi i veprës “Hamleti”.	2
14	Letërsia e vjetër shqipe: Gjon Buzuku, Lekë Matrënga, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani, Jul Variboba	5
15	Klasicizmi në letërsinë europiane-Molieri-Tartufi	2
16	Iluminizmi në letërsinë shqipe-Voskopoja- Theodor Kavaliotin, Dhanil Haxhiun dhe Dhaskal Todh- rin	2
17	Letërsia shqipe me alfabet arabo-turk – Nezim Frakulla, Hasan Zyko Kamberi, Muhamedt Kyçiku	3
18	LEKTYRA – Të përpunohen katër lektyra sipas për zgjedhjes së mësimdhënësit në akordim me nxënësit	4
19	Përsëritje	10
	Numri i tërësishëm i orëve të realizuara nga moduli Letërsi	51

3. Rekomandime didaktike

Propozim programi i shkurtuar për lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi për arsimin e mesëm katërvjeçar profesional për vittin e parë është i akorduar me nevojat për realizimin e mësimin me numër më të vogël të ditëve mësimore në akordim me kushtet dhe i ndarë në dy module: gjuhë dhe letërsi

Nëpërmjet **modulit Gjuhë** aftësitë dhe shkathtësitë komunikimit kryesisht duhet të ushtrohen dhe praktikohen në formën e folur dhe të shkruar përmes formulimeve të sakta gjuhësore dhe respektimit të rregullave gramatikore të gjuhës standarde (letrare) moderne. Përdorni tekste me shembuj të funksioneve të ndryshme të gjuhës me prezantime audio-vizuale të funksioneve të shenjave në pikëpamje të ndryshme artistike. Përveç teksteve, regjistrimet e tingujve mund të përdoren me shembuj që ilustrojnë ndryshimet midis të folmeve popullore dhe gjuhës standarde, ushtrime për shndërrimin e tekstit dialektor në standard dhe anasjelltas, fotografi për krahasimin e llojeve të shkronjave, si dhe shembuj të ideogrameve moderne dhe gjuhës së tyre etj. Gjatë realizimit të pjesës së fonetikës, përdorni materiale përkatëse të përshtatura, bëni krahasim të tingujve dhe zërave dhe tingujve e zhurmave me njësitë fonetike, përdorni regjistrime të tingujve për artikullimin korrekt, si dhe ushtrime për të ilustruar ndryshimet e zërit në formën e folur dhe të shkruar. Gjatë realizimit të pjesës së fonetikës ndërlidheni me drejtshkrimin, ndërlidheni edhe me elemente nga lirika me mjete shprehëse të cilat emërtohen si fonetike/fonologjike. Pjesën rrokja dhe theksi ushtrojeni më shpesh, ndërkaq në ato dy orë të caktuara potenconi rregullat. Për realizimin e njësive mësimore të morfologjisë bëni analizë dhe ushtrime gramatikore me shembuj nga tekste të ndryshme, përmes të cilave nxënësit do të jenë në gjendje t'i zgjerojnë njohuritë e përfituara. E njëjta vlen edhe për sintaksën.

Përmbajtjet nga moduli Letërsi vendoseni sipas rezultateve të prashikuara duke i ndërlidhur standardet për notimin e të arriturave me qëllim që të përfitoni përmbajtje nëpërmjet të cilave nxënësit do t'i aftësoni të lexojnë, kuptojnë dhe interpretojnë duke fituar dituri të cilat do t'i praktikojnë në tekstet artistike dhe jo artistike. Në të vërtetë, moduli letërsi, përmes rezultateve të nxjerra nga të mësuarit, kërkon nga nxënësit t'i gjejnë, t'i njohin dhe t'i klasifikojnë llojet e teksteve, t'i interpretojnë dhe vlerësojnë si këngë lirike, epike ose dramatike dhe t'i kërkojnë elementet e tyre njohëse. Poashtu, në tekstet ata duhet t'i njohin informacionet të cilat do të u ndihmojnë jo vetëm në përkufizimin e faktetve të veçanta për ngjarjet, kohën dhe vendin, por edhe për informacionet dhe cilësitë e personazheve, mjeteve stilistike, elementet nga veprat që do t'i udhëzojnë në epokë ose drejtimin stilistik së cilës i përket vepra. E gjithë kjo do jep mundësi për kuptim më të gjërë dhe të përgjithshëm të tekstit të një kulture dhe kohë të caktuar të zhvillimit të mendimit dhe artit.

Gjatë të mësuarit të elementeve lirike në programin e rregullt janë të numruara më shumë shprehje stilistike. Ato nuk pritët të mësohen për njëherë për dy orë që në këtë program ia përkushtuam lirikës. Realizimi i pjesës për komunikimin praktik-profesional të jetë sa më konkret. Prej arsimtarëve pritët për secilën njësi mësimore në fazën e planifikimit dhe shkrimit të përgatitjes për orën e mësimit, t'i definon rezultatet e të nxënit për orën mësimore që çojnë në realizimin e qëllimeve të përcaktuara nga programi dhe të jenë sa më konkret. Gjatë planifikimit duhet patur kujdes pasi që rezultatet e të nxënit ndryshojnë. Disa prej tyre mund të arrihen më shpejtë dhe më lehtë, por shumica prej tyre kërkojnë më shumë kohë dhe aktivitete të ndryshme.

Strategjitë e të mësuarit: -Strategjia e të menduarit kritik (përforcimi i të menduarit kritik gjatë të mësuarit e një lënde ose problemi përkatës, sjelljen e përfundimeve pas analizës së provave-citateve, krahasim);
-strategji (shpjeguese) përrshkruese (aftësimi i nxënësve për të përcjellë informacionin në mënyrë të shkurtër dhe të qartë, duke krahasuar me atë që ata tanimë e dinë me atë që dëgjojnë, duke kuptuar atë që e mësojnë dhe zbatimin e saj).

Propozim metodat dhe teknikat për realizimin e orëve – shfrytëzoni teknika/mënyra të cilat nuk iu marrin kohë për realizim, por janë efektive dhe me këtë do të keni orë në të cilën do të ketë lëvizje dhe do të keni edhe kohë për sintezë.

Numri i orëve të propozuara në këtë program të shkurtuar sipas përmbajtjeve nuk është i fiksuar. Prandaj, sipas nevojës, momentit dhe kushteve mund të bëni ndryshimin e numrit të orëve por jo edhe ta kaloni totalin e 96 orëve të këtij programi. Madje, nëse vlerësoni se është nevoja mund të bëni edhe ndryshime në përmbajtjet e propozuara të këtij programi.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin mësimor të shkurtuar e realizon arsimtari në akordim me normativin për kuadër mësimor i dhënë në programin e rregullt mësimor.

Скратената наставна програма по наставниот предмет **Албански јазик и литература** за **I (прва) година** на четиригодишното средно стручно образование за учебната 2020/21 година ја утврди

Арх. Бр. 13-9335/4

16.9.2020 година

Министер за образование и наука,

Мила Царовска